Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguetie

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

NEDELNI LIST
FLETORE E PERJAVESHME

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 96 din
— 6 muej 48 —
— 3 muej 24 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 119 | PRISHTINE, 27 Qershuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

NE NDERE TE KONGRESIT TE PESTE TE PARTIS KOMUNISTE TE JUGOSLLAVIS

Proklamatë e Frontit populluer te Jugosllavis me rastin e regjistrimit te Huas popullore

Qytetar e qytetare te Jugosllavis,

Ne saje te perpjekjeve qe keni dhane ne punen per ndertimin e Jugosllavis se re, Vendi i yne po ngrihet me nji rrfhem te fuqishem nga shkretnimi i luftes dhe mbrapambetunija e ngahershme e po kalon ne ndertimin socjalist.

Qeverija e jone e Frontit populluer, thellesisht koshjente se ndertimi i socjalizmit u pergjigjet interesave dhe nevojave jetesore te shtresave te gjana te Jugosllavis se re, ndermerr te gjitha masat e nevojshme per realizimin sa ma te shpejte e ma te plote te ketyne interesave dhe aspiratave te popujve t'one.

Nji nga masat e tilla te mdhaja te qeveris s'one, asht padyshim edhe vendimi mbi shpalljen e huas popullore.

Huaja popullore do te jete ndihme e re e madhe e njerzve t'one te mundit per atdheun e vet-kjo do te jete inkuadrim forcash te reja, mjetesh te reja te randesishme ne ndertimin t'one socjalist. Prandaj asht e kuptueshme se te gjithe qytetaret t'one patriote, me une te huas popullore, do t'investojne ne ekonomin t'one pjesen e konsiderueshme te mjeteve te tyne financjare per t'a shpejtesue ndertimin socjalist dhe ngritjen ma te shpejte te standardit te vet jetesuer. Fabrikat e reja, hekurudhat, shkollat, spitalet e reja do te perfaqesojne njikohesisht ngritjen ekonomike dhe lulzimin kultural te mbare Vendit dhe jeten ma te bukur te sejcilit individ.

Puntor, katundar, intelektueal puntor, njerez te mundit te Jugosllavis se re, ndertuesa te socjalizmit.

Te bashkuem ne Frontin populluer, t'udhehequn nga Partija Komuniste dhe shoku Tito, na krijojme ardhdhmenin ma te bukur e ma te lumtun per te cilen dikur kemi mujte vetem me andrrue. Duhet te hecim ma me guxim dhe ma shpejte kah mireqenja e plote dhe lulzimi i atdheut t'one madheshtor. Mbrenda afatit sa ma te shkurte t'a regjistrojme huan popullore dhe t'u apim hov te ri forcave produktive te Vendit t'one. Realizimi i huas don te thote ndertim ma i shpejte i socjalizmit. Prandaj regjistrimi i huas asht veper e madhe e pergjithshme popullore. Pjesmarrja ne realizimin e saje asht ndere per çdo qytetar te Vendit t'one.

Puntor e puntore,

Gjithmone keni qene ne rradhet e para te krijonjesave dhe ndertuesave te Jugosllavis se re. Te jini ne rradhet e para te regjistruesave te huas popullore. Rritja ma e shpejte e industris s'one, e komunikacjonit t'one, rindertimi ma i shpejte i qyteteve t'ona te shkatrrueme — kjo asht vepra e madhe e perkushtimit t'uej ndaj Jugosllavis se re dhe shokut Tito. Huaja popullore don te thote maqina ma te mira e ma moderne per industrin t'one, don te thote ma shum mjete per ngritjen e gjithanshme te klases t'one puntore. Jepni shembuj dhe te jini mobilizuesa te masave te gjana popullore ne vepren e madhe te realizimit te huas popullore. Edhe kesaj here percjellni patriotizmin t'uej te flaket ne te gjitha shtresat e njerzve t'one te mundit.

Katundar e katundare,

Per krijimin e Jugosllavis se re ju keni dhane sakrifica te çmueshme, dhe per ndertimin e saje keni dhane forcat t'ueja shum te mdhaja. Edhe huaja popullore le te bahet ne mase te plote veper e njerzve t'one punuesa ne katund. Jugosllavija e re e ka ndryshue mire katundin t'one, e ka nxjerre nga mbrapambetunija shekullore. Per ket flet shprehimisht dhe ne menyre konseguente reforma e zbatueme agrare, harmonizimi i çmimeve, ndihma e vazhdueshme kooperativave shlyemja e huanave, paksimi i tatimeve.

Huaja popullore don te thote perparimi i shpejte i katundit t'one, don te thote maqina ma te mira e ma te lira, almise dhe prodhime tjera industrija'e per katundin t'one, don te thote forcimi i kooperativave, don te thote shkolla, spitale, rruge te reja. Prandaj te gjithe ne rradhet e regjistruesave te huas popullore, ne rradhet e ndertuesave te jetes ma te mire e ma te lumtun ne katundin t'one.

Aktivista t'organizatave lokali te dhe t'organizatave masovike.

Agitacioni ma i gjane masovik le t'ia baje te mundun çdo qytetarti t'one me u-ba regjistrues i huas popullore.

Te jeni flamurtare t'organizimit shembullor te regjistrimit te huas.

An'e kand vendit t'one organizoni garen e regjistruesave te huas.

Puntor, katundar, intelektual, shkenetar, gra, rini e pionier.

Te regjistrojme hua qe vendi i yne te bahet ma i forte e ma i pasun. T'ia apim atdheut kursimet t'ona nga puna per t'a forcue industrin dhe bujqesin t'one — per t'a ba Vendin t'one te lumtun e te pasun.

Regjistrimi unanim i huas le te jete manifestim i ri i dashunis dhe perkushtimit ndaj Jugosllavis se re.

Fronti populluer i Jugosllavis

Regjistrimi i huas popullore fillon me 1 korrik

Ne baze te kryerreshtit 1, Neni 7 i Dekret-ligjit mbi huan popullore te Planit pesvjeçar te zhvillimit t'ekonomis popullore te RFPJ, Qeverija e RFPJ bjen vendimin mbi fillimin dhe zgjatjen e regjistrimit te huas popullore te Planit pesvjeçar te zhvillimit t'ekonomis popullore te RFPJ.

Regjistrimi i huas popullore te Planit pesvjeçar te zhvillimit t'ekonomis popullore te RFPJ fillon me 1 korrik 1948 dhe vazhdon ma se shumti 30 dite.

Beograd, me 21 qershuer 1948.

Kryetari i Qeveris se RFPJ dhe Ministri i mprojtjes popullore Marshali i Jugosllavis Josip Broz — Tito

Ministri i financave
Dobrivoje Radosavleviq

Kongresin e Partis s'one Komuniste do t'a presim me fitore te randesishme

—thone kooperativistat e Vrelles

Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis — Beograd

Na, antaret e kooperatives bujqesore te punes "Stanko Buriq" — Vrelle — te mbledhun ne konference me rastin e Dekretit te Qeveris s'one Qendrore mbi Huan e mbrendeshme popullore, unanimisht e pershendesim kete mase, te bindun se kjo do t'a shpejtesoje realizimin e Planit t'one te Titos dhe deklarojme se e gjithe kooperativa e jone do t'i pergjigjet kesaj thirrjeje. Kongresin e Partis s'one te dashtun do t'a presim me fitore te randesishme edhe ne ne Huan popullore, e cila e shpejton procesin e ndertimit socialist t'atdheut t'one.

Antaret e kooperatives bujqesore te punes "Stanko Buriq" Vrelle

Rrethi i Gjakoves i pergjigjet fteses se rrethit Belice ne gara

Garat per ndere te Kongresit te Peste te P.K.J. kane marre hov te madh kudo. Plenumi i keshillit te Frontit per rrethin e Gjakoves pranoi ftesen e Frontit te rrethit te Belices (Serbi) per gara dhe i zgjanoi zotimet e tija edhe me keto pika: kush ka me hape ma shum dyqane kooperative neper katunde, kush ka me regjistrue ma shum hua dhe kush e kryen regjistrimin ma pare, kush do t'u ndihmoje organizatave te grave, te rinis per kryemjen e detyrave te tyne; kush ka me organizue ma shum brigada puntore te rinis dhe me i dergue n'akcjonet e punes. Ne lidhje me zgjanimin e detyrimeve, Fronti i Gjakoves zotohet se do te jape 520.000 ore pune vullnetare n'akcjonet e punes dhe te ndertoje plotesisht 5 shtepija kooperative, te permirsoje tregtin, te hape ne qytet 25 e ne katunde 14 dyqane te reja kooperative, ta forcoje agitacjonin per regjistrimin e huas popullore; te perfshije ne brigadat e punes 60 per qind te rinis popullore dhe t'i dergoje n'akcjonet e punes.

Sipermarrja e ndertimeve „Graçanica" ne gara

PRISHTINE:

Kolektivi puntor i sipermarrjes se ndertimit »Graçanica«, me 21 te ketij muejit i mblodhi rezultatet e arrijtuna ne dekaden e dyte te garave per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Simbas rezultateve te mberijtuna, kolektivi puntuer i „Graçanices" e ka plotsue planin e prodhimit 130, 6 per qind, e detyrimin qe kane marre per ndere te Kongresit e kane tejkalue me 0, 6 per qind. Edhe ne ket dekade mbeten si ma te mirat brigadat puntore te dekades se pare — brigada e Mihajllo Stefanoviq, e cila e mbajti prap flamurin kalimtar te deges sindikale, brigada e Izet Halitit dhe brigada e Gjorgjeviq Jankos.

Premtimet e puntorve te tjegullave ne Gilan

Gilan

Ne konferencen qe asht mbajte ne keto dite ne punishten e tjegullave ne Gillan, puntoret e kesaj punishte, per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, kane premtue qe per çdo tezge te shtojne 500 cope tulla ma teper, keshtu tezgat qe prodhojshin 2500 cope tulla ne dite, tashma kane me nxjerre 3000 cope ne dite, e tezgat qe prodhojshin 3500 cope, kane per te nxjerre 4000 cope ne dite. Gjithashtu kane dhane premtime per t'a permiresue kualitetin e tullave.

Puntoret e sipermarrjes se ndertimit „Ramiz Sadiku" u shpallen gara atyne te „Graçanices"

Ferizaj

Puntoret dhe mjeshtrat e sipermarrjes se ndertimit „Ramiz Sadiku" ne Ferizaj, kane dhane premtime per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, per me e zbrite çmimin e plote te kushtimit me 10 per qind; me i zvoglue shpenzimet ne gelqere, ne drrasa dhe me e ba ndamjen e fuqis se krahut ne perpjestim te drejte ne deget e ndryshme te punes ne sipermarrje. Keta kane marre persiper me e kalue normen e parapame ne te gjitha punet me 20 per qind, me e forcue disciplinen ne pune, e ne rast nevoje me dhane edhe pune vullnetare.

Ne te gjitha keto pika, sipermarrja ne fjale i shpalle gare sipermarrjes se ndertimeve „Graçanica".

Aftesimi i puntorëve per mjeshtra

Gilan

Ne konferencen qe kane pase mjeshtrit e deges se sipermarrjes se ndertimit ne Gillan per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, kane marre persiper qe mbrenda ketyne tre mnejve çdonjeni prej tyne ka me i aftesue dhe me i ba te kualifikuem nga dy puntore, si mjeshtra.

Antifashistet e rrethit te Prishtines i ftojne ne gara ato te Ferizajt e Lipjanit

Antifashistet e rrethit te Prishtines ftojne ne gara antifashistet e rrethit te Ferizajit dhe Lipjanit veç tjerash edhe ne keto pika: deri ne Kongresin e Peste te PKJ kush do te jape ma teper azile femijsh per sezonen e veres, kush do te jape ma teper ore pune vullnetare per ndertimin e shtepijave kooperative dhe ne pune tjera, sidomos bujqesore, siç asht mihja e misreve, korrjet etj. Keto do te zhvillojne gara edhe ne lidhje me ndihmen sa ma te madhe vend-verimeve te femijve.

Kooperativa e perpunimit te metaleve „Eduard Kardelj" ne garë me te gjitha te tjerat

JANJEVE:

Per ndere te Kongresit te Peste te Partis komuniste te Jugosllavis, kooperativa e perpunimit te metaleve "Eduard Kardelj" ne Janjeve, u ka shpalle gara te gjithe kolektivave te industris se metaleve te ketij llojit ne atdheun t'one. Qendra e gares asht lshtimi i prodhimit, kursimi i landveq te para dhe pakesimi i çmimit te kushtimit.

Puntoret, nepunsat e nxanësit n'ekonomi ne Prishtinë i pergjigjen si duhet huas popullore

Neper te gjitha sipermarrjet dhe institutet e Kosmetit, puntoret e nepunsat po japin premtime per dhanjen e huas popullore shtetit t'one. Ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ puntoret dhe nepunsat e sipermarrjes tregtare te Prishtines jane zotue se do te regjistrojne shumen prej ma se 100.250 dinare.

Mjeshtrat dhe puntoret e kooperatives kpuctare „Bratstvo" ne konferencen e tyne sindikale ne te cilen u spjegue randesija, qellimi dhe karakteri populluer i kesaj huaje, dhane detyrimin se do te regjistrojne ma se 38.000 dinare, dhe premtojne se jane gadi me regjistrue edhe ma teper, sepse „na e kemi kuptue fare mire randesin dhe dobin e madhe qe ka huaja per ngritjen e jetes s'one ma te lumtun" — deklarojne puntoret ne proçes-verbalin e konferences.

Dega sindikale Nr. 7 prane Keshillit Krahinuer t'invalidve te luftes ka dhane deri tash premtimet ma te mira — 80 vetë qe kane marre pjese ne konference, do te regjistrojne ne hua 351.250 dinare. Duhet theksue se aproksimativisht çdo antar i deges sindikale ka premtue se do te regjistroje hua ma teper se nga 3830 dinare, d. m. th. ma teper se sa rroga e plote mujore e tyne. Ndër keta invalide ka edhe asish qe kane regjistrue shuma mjaft te mdha, si p. sh. Perezhanin Jefto, i cili ka re-

(Vazhdon ne faqen e dytë)

Fronti popullueri Gjakoves i fton ne gara te gjitha rrethet e Kosmetit per regjistrimin e Huas popullore

Plenumi i keshillit te Frontit popullue per rrethin e Gjakoves, u drejton te gjitha rretheve te Kosmetit me ane te fletores s'one ket leter:

„T'entuziazmuem me shpalljen e huas popullore te Planit pesvjeçar, ne konferencen e rrethit te Frontit popullue, vendosem me i ftue ne gara te gjitha organizatat e Frontit popullue te rretheve ne Kosmet.

Njeriu i punes e kupton se çfar randesije te madhe ka regjistrimi i huas per ngritjen e mireqenjes se pergjitheshme popullore, per realizimin e Planit pesvjeçar — per ndertimin e socjalizmit. Na e dijme se huaja don me thane ma shum shkolla, ma shum traktora, maqina korrse e fshise, ma shum fabrika, prandaj do te bajme çmos qe t'i sigurojme na vete mjetet financjare. Regjistrimi i huas u shpall bash ne ditet historike — para Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, prijses se popujve t'one ne lufte per ndertimin e socjalizmit dhe organizatores se te gjitha fitoreve t'ona, — prandaj randesija e huas ka randesi aq ma te madhe. Me regjistrimin e huas do t'u tregojme te gjithve se populli i yne, nen udheheqjen e Partis s'one te lavdieshme dhe prijsit t'one shokut Tito, do te ape gjithshka qe nevojitet per ndertimin e socjalizmit.

Prandaj i ftojme te gjitha organizatat e Frontit popullue te rretheve te Kosmetit ne garen: kush do t'i kryeje ma me sukses te gjitha pregatitjet per regjistrimin e huas: kush do te mbaje ma shum konferenca, ligjerata dhe seminare, dhe kush do t'a njofe popullin ma mire me randesin e huas neper biseda individuale, kush do te regjistroje ma pare e ma shum hua, per t'a prite ma me krenari e mburrje Kongresin e Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis"

Nga mbledhja e plenumit te Keshillit te Frontit popullue te Rrethit te Gjakoves.

Huaja popullore shpejton plotsimin e Planit pesvjeçar dhe forcon fuqin mprojtëse t'atdheut t'onë Socjalist

(Vijon nga faqja e pare)

gjithne shumen prej 60.000 dinaresh, Spasiq Gjpe 50.000 dinare, Dimitrijeviq Steve 20.000 dinare e disa te tjere nga 15.000 dinare.

Disa nenes n'ekonomi kane regjistrue hua ma te madhe se sa e kane rrogen e tyne mujore.

Kjo dege sindikale, tue ndjeke traditat luftarake te luftes Nac. Cir., u shpalli gara te gjitha degave sindikale per ndere te Kongresit te Peste te PKJ. Ne thirrjen qe bajne, ata zotohen se do te regjistrojne hua ne natyrin e nji rroge mujore, e bile edhe ma teper. Simbas numrit t'antarve ata do te regjistrojne hua ma shum se çdo dege tjeter sindikale dhe mbrenda kohes ma te shkurte.

Sindikalistat e stacjonit magji-o-tra'torist jane zotue se do te regjistrojne huan prej 94.000 dinaresh.

Puntoret e fabrikes se tjegullave dhe te tullave ne Prishtine do t'apin huan prej 101.000 dinaresh. Nepunsat e keshillit popullue te qytetit kane regjistrue shumen prej 80.000 dinaresh.

Nga te gjitha keto premtime e regjistrime, kuptohet se si puntoret ashtu dhe nepunsat e kane kuptue shum mire randesin e huas popullore, e cila e ndihmon realizimin e Planit pesvjeçar dhe ndertimin e socjalizmit — jetes ma te lumtun per te gjitha masat punonjese te popujve t'one.

ka dhane ket deklarate: „apo ndiesi shoke: une perafimend rroge aq te madhe s'kam, e ju e dini se sa femije kam, por mbasi po e dije mire se per çka epet kjo huaja, qysh ketu po jap fjalen se jo nji rroge por edhe dy kam me i dhane, bash me e dijte se do te heki keq per dy muej". Shoket e grupit te tij jane preke teper nga kto fjale dhe i kane pergjegje: „bravo te kofte bre Muharrem se perafimend konke taman shok. Mos ke gajle se, mbasi na ke dhane ti shembullin e pare se si duhet me e shique huan popullore, na te gjithe ta napim fjalen se nuk kemi me te lane keq per kurrgja, as per buk, as per veshe, as per dru e as per kurrgja".

Ne rrethin e Lipjanit 45 gra premtuen me dhane 30.000 dinare

Korespodenti i veçant i fletores „Rilindja" na lajmeron se ne konferencen e mbajtun nga Fronti i gruas luftabaliste te Lipjanit ne lidhje me huan popullore, 45 gra dhane me nji here detyrimin se do t'apin 30.000 dinare e Sara Solomonoviq, shtepijake deklaroi se, pamvarsisht nga i shoqi, ajo vet ka me dhane hua 1.000 dinare n'emen te saje dhe nga 250 dinare per sejcilin prej 4 femijve qe ka. „Po pse mos t'i ap hua shtetit, thot ajo, kur e dije se kam me pase dyfish fitim: nga nji ane me kthehen prap te hollat e mija, si dhe interesi 6% dhe e kam te sigurueme pa kurrnji pare biletën e llotaris, ne fondin e se cilës shteti ka me hjedhe miljona dinaresh, e nga ana tjeter ndihmoj ne shpejtesimin e ndertimit te socjalizmit, qe na siguron nji jete edhe ma te mire per ne e per femijt t'one."

Neper te gjitha seksjonet e minjeres „Golesh" po zhvillohen gara per Huan popullore

Korespondenti i veçant i fletores „Rilindja" na lajmon nga Goleshi se kolektivi i punës i kesaj minjere do t'a pres Kongresin e Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis me fitore te randesishme edhe ne lidhje me Huan e mbrendeshme popullore, qe ka per qellim me e shpejtue plotesimin e Planit pesvjeçar te Titos, me e forcue fuqin mprojtese t'atdheut t'one socjalist. Neper te gjitha seksjonet e minjeres po zhvillohen gara. Asht per t'u vue ne dukje shembulli i shkelqyeshem, i dhanun prej puntorit cigan, Muharrem Ismailit. Ai, me gjithe se nuk ka kurrfare burimi tjeter t'ardhunash pervoç rroges per te mbajte veten, gruen dhe disa femij te tij, fille mbas konferences qe asht mbajte ne lidhje me huan popullore, asht çue i pari ne kambe dhe, tue iu drejtue shokve te vet,

Fronti popullueri Dobranjes nuk asht aktivizue sa duhet

Korespondenti i veçante i fletores „Rilindja" na lajmeron se ne Dobranjen e Madhe keshilli i Frontit te katundit asht aktivizue teper pak, e bile gadi aspak. Ne lidhje me huan popullore nuk asht studjue Dekreti perkates, nuk u jane sqarue katundarve qellimet dhe randesija e huas. E pra Dobranja duhet t'i pergjigjet mire kesaj detyre mbasi asht katund shum i pasun. Udheheqesija e Frontit duhet te mbaje lidhje te vazhdueshme me keshillin e Frontit te Dobranjes e t'i ndihmoje gjithnji per kryemjen me sukses te ketij aksjonit te madh.

Te gjitha perfitimet e dekretit te ri te blemjes se drithnave mund te çfrytezohen vetem me kontraktimin para korrjeve

Plani i pergjithshem i kontraktimit te drithnave te bardhe deri me 22 te ketij muaji asht realizue me 39% (dhe ai i misrit me 16, 96%).

Rezultatet ma te mira jane mbrrijte ne rrethin e Pejes, ku plani i kontraktimit te drithnave te bardhe—i parapame per t'u realizue deri me daten 22 te k. m. — asht plotsue me 140,71%. Mbas ketij vjen rrethi i Istokut me 80,81%, i Drenices me 59,70%, etj. Rezultatet ma te dobta jane mbrrijte ne rrethin e Kamenices, ku plani asht realizue me 20,21%, n'ate te Rahovecit me 21,50%, i Mitrovices me 34,84% dhe Gjakoves me 40,84%.

Persa i perket kontraktimit te misrit rezultatet ma te mira i ka mbrrijte rrethi i Istokut, ku asht realizue plani me 60,52%. Rrethi i Suharekes ka kontraktue gjithsejt 0,17%, i Gjakoves 0,43, i Rahovecit 7,19%, i Podujeves 8,164%.

Nga keto sukses te pakenaqshme shifet se nuk asht ba sqarimi i gjithanshem i Dekretit; agitacjoni nuk i asht kushtue kujdes dhe organizatat popullore nuk jane angazhue aq sa duhet. Kjo asht arsyeja qe ne rrethin e Rahovecit nuk jane mbrrijte rezultate te mira, me gjithse asht njeri rrethet ma te pasuna me drithna te bardhe dhe ka mundesi me e mbajte vendin e pare. Ne fillim kontraktimi zhvillohej me hov ma te madh ne rrethin e Prishtines, i cili u shpalli gara te gjitha rretheve te Krahines s'one, mirepo ma vone, tue e marre zgjidhjen e kontraktimit si çeshtje lushtate dhe tue mos u angazhue sa duhet, ka mbete ne vendin e shtate. Ne disa vende kane mungue bonat per nji kohe, por kjo nuk ka qene arsye qe kontraktimi te vonohej mbasi jane dhane udhezime qe ne vend te bonave te leshohen diftesa te perkoheshme, te cilat ma vone do te zavendesoheshin me bona. Ne rrethin e Gjakoves, Pejes e Drenices ne vend te diftesave te perkohshme jane leshue diftesat e caktueme per ekonominat e vogla katundare ne lidhje me tregtin me çmimet e lidhuna. Tue qene se keto diftesa nevojiten per ekonominat e vogla katundare, me

fenen e te cilave ata do te mujne me i shite te gjitha prodhimet e veta dhe me u furnizue me artikuj industrijale ne baze te sistemit te tregtis me çmime te lidhuna, duhet te terhiqen me nji here nga kontraktuesit dhe te zavendesohen me bonat perkates.

Kontraktimi i drithnave asht nji detyre me randesi e pergjegjesi shum te madhe dhe nga kryemja e tij me sukses mvaret shum sigurimi i bukes se nevojshme per njerzit punonjes, qe po luftojne per realizimin e Planit t'one pesvjeçar. Per kete arsye kontraktimi te drithnave e sidomos tash te drithnave te bardhe, mbasi kontraktimi i misrit asht perfundue perkohesisht deri me 15 korrik te k. v., duhet t'i kushtohet randesija e duhun si nga ana e kooperativave, ndermarrjeve te grumbullimit ashtu edhe nga ana e organizatave popullore. Duhet te behet çmos qe katundarve t'u sqarohen thellesisht te gjitha dispozitat e Dekretit dhe perfitimet qe i kane nga kontraktimi. P. sh. ne vjetin e kaluem katundari ka mujte me marre per 100 kgr. grun vetem 330 dinare ne te holla, kurse tash tue kontraktue mundet me marre per te njajten sasi 515 dinare ne te holla si dhe bonat perkatese per t'u furnizue me artikuj industrijale me çmime t'unjisueme ma t'ulta. E çka asht ma e randesishme, bujqit kontraktuesa perfitojne bonat perkatese per te tane sasin e kontraktueme dhe e gjithe kjo sasi do t'u zbritet nga sasija e detyrueshme. Asht shum e dobishme per katundarine t'one punonjese qe te kontraktoje jo vetem tepricat e detyrueshme, por edhe tepricat e lira. Te gjitha avantazhet e Dekretit mund te çfrytzohen vetem me anen e kontraktimit para korrjeve. Po sa te filloje blemja e detyrueshme humbet mundesija e kontraktimit dhe bujqit qe s'kane kontraktue do t'i dorzojne tepricat e drithit pa perfitimin e bonave dhe me çmime ma te vogla per 25%.

Aktivet e agitatorve duhet te vizitojne çdo shtepi, t'iu tregojne prodhuesave ne menyre bindese e me shembuj konkrete perfitimet qe kane nga kontraktimi dhe te lidhin kontrata me ta sa ma pare. N'anen tjeter nji nga detyrat ma randesi te keshillave popullore, t'organizatave masive dhe t'aktiveve t'agitatoreve asht qe te marrin pjese ne caktimin e drejte te prodhimeve. Baza per agitacjonin e drejte dhe suksesin e kontraktimit asht caktimi i drejte i prodhimit. Komisjonet perkatese duhet te shkojne ne çdo are dhe ne baze te gjendjes reale te caktojne prodhimin e te ndikojne te prodhuesit me sqarime konkrete qe te kontraktojne sa ma shum drithna. Prandaj kesaj çeshtje duhet t'i kushtohet randesija e duhun. Ka randesi te madhe dhe perbamja e komisjoneve per caktimin e prodhimit. Ne krye te komisjonit duhet te jete kryetari ose sekretari i keshillit te vendit si dhe njerzit ma te mire te keshillit te vendit dhe t'organizatave popullore.

Organizatat e Frontit duhet t'u shtojne punen e tyne rreth sqarimit te Dekretit. Njikohsisht duhet me e sqarue edhe dispozitën ne lidhje me trezinet e misrit dhe t'u bahet e kjarte kontraktuesave se ne raste te keqija caktimi i prodhimit do te bohet me anen e komisjonit te veçante ne baze te gjendjes se vertete te frytit te korrun.

Komisjoni do te çmoje damin e bame dhe simbas konstatimit te gjendjes se vertete te frytit do te caktoje perqindjen e dorezimit te drithit. N'anen tjeter, organizatat e Frontit duhet te luftojne kundra çdo orvajtjeje, ase parulle t'elementave spekulanta, te cilet perpiqen me e pengue kontraktimin, tue e shtremnue Dekretin se gjoja „sasinat e kontraktueme nuk do te zbriten nga sasija e detyrueshme", se „nuk do te bahet berqeti" etj. P. sh. ne katundin Gjelekar te rrethit te Gilanit jane kontraktue sasina te pakta per shkak te qendrimit te keq te disa pasanikve t'atij katundi, te cilet thone se „do te bjen imjeglla e do t'i prishe drithnat e bardhe". Nji pjese e mire e pasanikve te katundeve e kundershtojne haptazi kontraktimin, sepse tipave te ketij soji, qe e kane ne shpirt spekulimin, nuk ju bjen per shtat kontraktimi dhe duen t'a pengojne ne çdo menyre vetem e vetem qe te mos te permirsohet standardi jetesuer i katundarit t'one punonjes. Kundra ketyne fare armiqve duhet me luftue dhe me i demaskue vendosmenisht, tue e cvilne punen e tyne te damshme me skjarimet sa ma te drejta e sa ma te gjana te dispozitave te Dekretit.

Agjitacjoni duhet te jete i vazhdueshem dhe sistematik gjate gjithë akcjonit te kontraktimit, per ket arsye asht e nevojshme me veprue ne kete menyre.

Agjitatoret duhet t'a dajne terenin d. m. th. duhet t'a kane numrin e caktuem te shtepive ku do t'agjitojne deri ne plotsimin e planit te kontraktimit. Agjitatoret rreth kontraktimit duhet te bahen ne baze te ndertimit individual per çdo prodhues. N'anen tjeter, komisjoneve per caktimin e prodhimit duhet me iu dhane ndihmen e gjithanshme mbasi kjo pune e ndihmon shum kontraktimin dhe u jep mundesi bujqve me kontraktue sa ma shum.

Kontraktimi nuk duhet te bahet vetem ne kooperativa, por neper vendet e ndryshme te prodhuesave, ne menyre qe lidhja e kontratave te bahet po veshtjerisht dhe te kryhet sa ma pare.

Kooperativat shit-blemse e kane per detyre te sjellin asi fare artikujsh qe katundarve u nevojiten ma se shumti, ne menyre qe te jene sa ma t'interesuem me kontraktue.

Tue zhvillue gara te gjithanshme edhe persa i perket kontraktimit dhe tue mbrrijte rezultate sa ma te mira, katundaret t'one punonjes, organizatat e Frontit, kolektivet e ndermarrjeve te grumbullimit te kooperativavet do t'a presin me krenari ma te madhe Kongresin e Peste te Partis s'one te lavdishme Komuniste te Jugosllavis.

Katundarija punonjese demaskon ata qe perpiqen me e pengue Huan popullore

Korespondenti i veçant i fletores „Rilindja" na lajmeron se ne katundin Ollogove te rrethit te Lipjanit asht mbajte nji konference e veçante dhe e gjane ne lidhje me huan popullore, randesin, qellimin dhe karakterin e saje popullor. Katundaret punuesa treguen mirkuptim te plote ne lidhje me ket kerkese qe u a dergon Qeverija e jone Qendrore popujve te vet, por disa elementa pasanike te katundit me nji here jane perpjeke me e pengue ket aksjon.

Si te tille jane per t'u permende Ifat Musa, Stanko Nedeljki e Danillo Vasiq. Interesant ka qene momenti kur njerzit prej shtresavet puntore te katundaris u a kane dhane pergjegjen e duhun ketyne elementave, te cilet mundoheshin me u paraqite si te kequtun fare ekonomikisht, si njerez qe nuk kane kurrgja mbas shpirtit. Masa e popullit u a tha atyne nder sy se jo vetem jane ne gjendje shum te mire ekonomike, dhe kane mundesi me i ba paret per t'iu pergjegje si duhet huas, por se edhe kane shuma mjafte te mdhaja te hollash gadi, pare hazer. Sikur tek nji pjese ma pasanike e katundaris mos te kishte pare hazer, te pshtjelluna nder mysherana, nder çarapa ose nder birucat tjera-thojshin katundaret, atehere sigurisht nji lope nuk kishte me kushtue ne pazar sa tashti, qe mbrrinë ne 30 mije dinare e perniShi, nji vae nuk kishte me ba deri tue 6 dinare nji pule nuk kishte me kushtue ne treg te lire deri ne 200 dinare e per mbi. Na e mbajme ne mende shum mire, shtojshin katundaret, se dikur, ne Jugosllavin e pare, e kena pase shite kilogramin e grunit deri ne 3 grosh ose edhe 2 grosh e gjysem. Tashti, ne tregun e lire disa po e shesin kilen e grunit ma teper se 30 dinare. Shka don me thane kjo? Kush shet per tregun e lire! Kjo don me thane se pare hazer ka mjafte ne katund dhe ata qe kane ma se plouti jane natyr'i ht katundarija e pasun".

Asht karakteristike nderhyemja ne diskutim e djaloshit Vllada Stanojeviq, te kthyem nga Armata Jugosllave. Ai ia qiti lakrat ne diell ushes se vet Danillo Vasiq, i cili, me gjithse ka 16 ha. toke, pervoç tjera pasunive, me nji menyre dredharake, perpiqej me e pengue zhvillimin e drejte te konferences, si i thone nji fjale, „tue hjedhe gurin e tue e mshefe doren". Secili duhet t'i pergjigjet huas popullore simbas mundesive te vertteta ekonomike qe ka, tha djaloshi ne fjale. Kete e ka per detyre çdo njeri i ndershem. Ne qofte se disa nga rradhet e katundarve pasanike duen me e paraqite punen sikur huaja te kishte karakterin e nji lemoshe na, populli, nuk do t'ua lejojme kete. "Dekreti mbi huan tregon se shteti i jone asht ma i forte se kurr nga pikpamja ekonomike dhe financjare. Huaja ka per qellim me e shpejtesue plotsimin e Planit pesvjeçar, qe asht n'interesin e shtresave te gjana popullore, pra edhe atyne katundare. Po keshtu foli edhe katundari Is Arifi me shoke. Masa e te pranishmeve i pershendeti fjalet e tyne dhe mbas diskutimit u vendos qe Gllogovci t'i shpalle gara katundit Gornjaselle dhe t'ia kaloje. Katundaret theksuen se garen ne lidhje me huan popullore do t'a zhvillojne ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, udheheqese se popujve t'one ne luften per liri e barazi dhe ndertimin socjalist.

Fiskultura dhe Sporti

Manifestimi fiskultural - pasqyre e forces, bukuris dhe krijueshmenis se Rinis s'one

Nji grup i fiskulturistave ne parakalim

Me 13 dhe 15 qershuer u-zhvillue ne Prishtine parada dhe manifestimi fiskultural. Ne ket manifestim madheshtuer muerren pjese te rijt e te rejat puntore e katundare, te rijt e fabrikave, ndermarrjeve dhe institucjeve, rinia shkollore, brezi i ynë ma i ri-pionirei, luftare t'Armates Jugosllave-mprojese te liris, pamvaresis dhe paqes ne Vendin t'one edhe fiskulturistat e shoqnive te ndryshme sportive.

Massat e gjana popullore, me perfaqsuesat e organizatave massovike te Frontit popullor, pushtetit popullor e t'Armates Jugosllave ne krye pa en rastin me pa se çka mundet me ba rinija e vendit ku pushteti asht ne duer te popullit, ku po zhvillohet lufta e perbashket e popujve te vllaznuem e te bashkuem per ndertimin e shoqnis socjaliste.

Me 13, pikerisht n'ora 12.30 Sekretari i Bashkimit fiskultural te Kosmetit, shoku Ramadan Vranigi, i paraqiti kryetarit te Frontit popullor, shokut Fadil Hoxha, raportin e parades. Prane tribunes se ngritun ne rrugen „Armata e Kuqe, trotuaret e te cilet ishin plot me mija e mija spektatore, parakaloi nji motoçiklete me dy flamuj te kalorsit fiskulturare. Mas asaj parakaloi grupi i pare i fiskulturistave me flamujt kombetare e fiskulturale me amblemat shtetnore, sindikale dhe sportive dhe me fotografijnat e Marshallit Tito dhe Dr. Blagoje Neshkoviqit. Ne formacjone çetash, te veshun ne kostume sportive parakalojen grupet e fiskulturistave ne marshin fiskultural, te percjellun nga muzika ushtarake, grupi i pionerve, fiskulturistat e sipermarrjes Trepça grupi i rinis katundare i veshun ne kostume fiskulturore te qepuna s'mbas modelit te kostumit kombetar, fiskulturistat e shkollave te mesme, fiskulturistat e shoqnive te ndryshme sportive te Krahines, nder te cilet edhe grupi i shoqnis se re „Tito", dhe ne fund grupi i fiskulturistave t'Armates Jugosllave. Paraden e mbylli nji grup fiskulturistash flamurtare.

Dy dite ma vone, me 15, u-mbajte ne stadiumin e shoqnis „Proleter" manifestimi madheshtor i fiskulturistave. Ne stadiumin e stolisun me qinda flamuj shtetnor e fiskultural, me pllakata te ndryshme sportive para ma se 10.000 spektatorve, u-paraqiten nje program te ndryshem fiskulturistat e Krahines s'one se bashku me fiskulturistat e Armates Jugosllave. Kurre deri tash popujt e Krahines s'one nuk kane pa nji manifestim kaq te bukur, kaq te hare e kaq masovik.

Mbas ketyne, u-paraqiten fiskulturistat e Pejes me ngjyrat te folklorit kombtar. Mandej u-nis nga fusha grupi i fiskulturistave per marshin partizan 15 kilometra rruge. U-paraqit mandej rinija katundare e cila e percjellun me muzike çfaqi levizjet tropore qe simbolizojshin punet e ndryshme bujqesore: mbjelljen, korrjen, levrimin etj. dhe ndertimin e rrugve. Tue kendue kange popullore formuen pesekendeshin. Grupi i valleve popullore shoqnis "Polet" u-paraqit ne formacjonin e rrjeshtuem me emnin "Tito".

Mandej u-zhvilluen disa gara t'atletikes se lehte: vrapime, vajzat me 80 metra dhe mashkujt me 100 metra, arriti nji grup i marshit partizan, i cili nuk i tui mbasi nuk u-kthyen te gjithe. U-çfaqen dhe ushtrime gjimnastikore, ku suksesin ma te mire e kurrgjet ekipa e Armates Jugosllave dhe grupi gjimnastikuer i femnave. Mandej u-paraqiten fiskulturistat e Mitrovices e Prishtines. Fiskulturistat e Prizrenit paraqiten me ushtrimin e tyne simbolin e fillimit te kryengritjes popullore, si vllaznohen njerzit, si luftojne dhe ndihmojne njeni tjetrin ne ndihme, paraqiten se si mbas fitores partizanet kendojne kange dhe bejne valle popullore. Mandej mbas çlirimit, simbolizimen punen ne perdhim, punen vullnetare. Momenti i fundit paraqiti punen si shej ndertimi ne socjalizem me Titon ne krye.

Mandej u-paraqit ekipa e boksjerve e mbas tyne fiskulturistat e shkollave te mesme.

E fundit, por ma e mira u- paraqit ekipa e fiskulturistave t'Armates Jugosllave. Ne paraqitjen e tyne ata simbolizuen, ne nji ane, perpjekjet e popujve t'one per ndertimin paqesuer te Vendit dhe, nga ana tjeter, Armaten si rueitjse syçelte e vigjilante te pamvaresis dhe paqes dhe, ma ne fund, valltja popullore e Titos e marshi i dales simbolizuen gazmendin dhe lumnin qe siguron Armata si rueitese e Vendit dhe puna e popullit per realizimin e detyrave qe shtron ndertimi i socjalizmit.

Ky manifestim qe pasqyre e suksesseve te mberritjuna ne fushen e fiskultures dhe ne te gjitha fushat e punes se popujve t'one, pasqyra e bashkimit dhe vllaznimit te popujve t'one. Ne perpjekjet qe jane ba nga ana e rinis s'one per ket manifestim asht pa se fiskultura asht mjeti dhe faktori i randesishem per ngritjen e kuadrave te shendosha te degeve te ndryshme te punes. Ky manifestim tregoi se ne gjirin e levizjes fiskulturore, jo vetem ndertohen kuadra per deget ekonomike, por edhe rueitesat e sigurte t'adhet t'one socjalist, luftetaret e qendrueshem kunder çdo agresioni eventual mbi pamvaresin t'one. Me ane te ketij manifestimi u-pa edhe roli edukativ i fiskultures s'one ne kundershtim me karakterin profit e antipopulluer te manifestimeve ne vendet kapitaliste. Fiskultura ke na asht ajo qe zhvillon ne njerzit t'one solidaresin dhe bashkpunimin e popullit puntor, asht ajo qe zhvillon ndjenjat ma fisnike nder njerez-ndjenjen e kolektivit, dashunis ndaj atdheut e punes, ndjenjen estetike. Ky manifestim na dha me kuptue se popujt t'one, sidomos rinija e jone, po u bjen grushte vdekjeje zakoneve dhe paragjykimeve prapanike qe jep bindje te plote se se shpejti do te likuidohet mbrapambetunija ke na dhe se ne ket pikepamje jane korre sukcese te mdhaja.



Fiskulturistat e Armates simbolizojne lirin dhe mprojtjen e Atdheut

Arsim e Kulture

Shkolla e Ulte medicinale e Pejes nxjerre kuadra te reja per sherbimin shendetsuer te popullit

Per permiresimin e shendetit te popullit dhe pregatitjen e kuadrave te reja t'afta shendetsore, Kryesija e Keshillit te Krygit te Kuq Krahinuer, ne muejin Maj 1947, hapi ne Peje ne gjuhe shqipe shkollen e ulte medicinale.

Gjate vitit shkolluer 1947-48 medicinen i kane vijue rregullisht 30 nxanese, nder te cilat, 10 jane t'ardhuna nga Republika Popullore e Shqipnis, e 20 nga vendet e ndryshme te Krahines Autonome te Kosmetit e nga Maqedonia.

Nder keto nxanese, 4 kane qene serbo-malazeze, te cilat krahas me shoqet e reja shqiptare i kane vijue mesimet ne gjuhen shqipe, tue mos hase ne veshtiresina.

Me hapjen e shkolles s'ulte medicinale ne Peje, iu asht dhane mundesi te rejave shqiptare, qe t'aftesohen dhe te marrin pjese ne plotsimin e detyrave shendetsore, gja qe perpara as qe mund te mendohej.

Me gjithe qe landet kane qene te veshtira, ne krahasim me kualifikimet e tyne shkollore, por me perpjekjet e jasht-zakonshme te ndimes reciproke, grupeve kolektive, disiplines shembullore ne pune, ne fund te vitit shkolluer asht mberri suksesi i duhun, tue i pervetsue landet e kultures se pergjithshme dhe veçanerisht ato mjeksore si epidemiologjin, higjenen, kirurgjin etj.

Veçanerisht ndihem te jashtzakonshme iu ka dhane ne çdo lande nxanesja Magbule Beratari, nga Republika Popullore e Maqedonis, me ndihmen e se cilës me leksioni i kane pervetsue landet edhe nxaneset tjera ma te dobta, keshtu qe te gjitha e kryen shkollen me sukses.

Nen prezencen e komisjonit provues, i perbam prej Danica Vukqeviq, perfaqsuese e Keshillit Krahinuer te Kryqit te Kuq, Dr. Durmish Celina, perfaqsues i Drejtoratit te Shendetsis dhe arsimtarve te landve nxaneset iu shtruen provimeve prej dates 11-16 qershuer dhe tregnen kete sukses: 15 me sukses te shkelqyeshem, 7 shum te mire dhe 8 te mire.

Ne kete vit nga kjo shkolle dalin nxaneset e kualifikueme ne degen e shendetsis qe do te sherbejne n'institutet shendetsore te Kosmetit, kudo qe te jete nevoja, ashtu si edhe vete kane deklarue.

Te rejat shqiptare me trupin mesimuer e komisjonin provues

Tue pa randesin e madhe te shkolles ne pregatitjen e kuadrave te reja shendetsore, veçanrisht per shqiptaret, asht mire qe ne vitin e ardhshem te regjistrohen ma shum te reja, keshtu qe edhe kuadrat shendetsore te shkojne krahas me te tjerat, per te cilat kemi nevoje te madhe ne permirsimin e shendetit te popullit.

R. Jusufi

Bashkimi i Shoqnive kulturalo-arsimore te Prishtines u shpalle gara te gjitha shoqnive te Krahines

Me 29 te ketij muej u-mbajte mbledhja e gjane e antarve te Shoqnis „Radniçki" dhe „Ramiz Sadiku". Ne rendin e dites, perveç leximit te referatit, u-ba diskutimi, u-zgjodh keshilli kryesuer drejtues dhe u-lexue Statuti i Bashkimit te Shoqnive kulturo-arsimore.

U-theksue qe tash me zgjedhjen e ketij keshilli shpresohet se te metat kane me u-zhdukë dhe puna ka me shkue mire, derisa Prishtina i ka te gjitha kushtet dhe intelektuale ma shum se çdo qytet i Krahines s'one.

Ne keshille u-zgjodhen shoket Dushan Popoviq kryetar, Neship Hablluaj nenkryetar dhe Surrej Jusufi sekretar. U-zgodhn edhe 16 antare nga te gjitha organizatat antifashiste.

Mbas leximit te Statutit, shoku Dushan Popoviq i falenderoi antaret n'emen te shokve te zgjedhun dhe premtoi se do t'apin sa ma shum, po ashtu si u asht dhane besimi.

Ma ne fund, si me pelqimin e te gjithve, ne nderë te Kongresit te Peste te PKJ, n'emen te Bashkimit u-shpalli gara te gjitha shoqnive te ketij rangu dhe atyne te rretheve ne keto pika:

1. Kush do te perfshije ma shum analfabeta ne kurset analfabetike, mashkuj e femna.

2. Kush do te perfshije ma shum njerez ne grupe leximi dhe kurse arsimore.

3. Cilat shoqni do te japin ma shum dhe ne kualitet ma te mire çfaqje theatrale.

4. Kush do te mbaje ma shum ligjerata nder universitete popullore, nder grupe puntoresh dhe nder rrone.

5. Kush do te regjistroje ma shum femij ne shkolle.

6. Kush do te baje regjistrimin e analfabetve me statistike ma te sakte e te perpikte deri me 21 korrik.

VASSILI GOSMAN — Me rastin e agresjonit gjermano-fashist kundra BRSS

Populli asht i pavdekshem

Ordhit gjermane vijshin nga prendimi. Ne karrot e tyne ishin vizatue krena te vdekunish, drangoj te verdhe e te kuq, gojna ujkut, bishtna dhelpne e koka kaprojsh me brij te mdhaj. Çdo ushtar gjerman mban ne xhepin e tij fotografina te Parizit te mundun, Varshaves se rrethueme, Verdunit te poshtnuem, Beligradit te djegun, Brukselit e Amsterdamit, Oslos e Narvikut, Athenes dhe Gdynjas. Ne çdo portofol oficeri, gjinden fotografina vajzash dhe grash gjermane... Çdo oficer mban gjana te çmueshme. Sejcili prej tyne mban ne xhep nji fjalorth ushtarak rusisht-gjermanisht, me kto fjalina lakonike: „Dupert nalte!", „ndalou!", „Ku jane ushtaret?" „Dorzou". Çdo ushtar gjerman ka mesue ne gjuhen rusishte emnat: qumesht, buke, voe, pule dhe foljen me dhane ne menyren urdhnore: „Davaj!".

Ata vijshin nga prendimi. Nderisa prej Okas me ujna te kthjellta, prej Volgas se gjane, prej Kamas se rrepte dhe te verdhe e Irtishit shkembuer, prej Astrakanit dhe Voronezhit, miljona njerez çobeshin ne kambe per t'u dale per balle. Me miljona krahesh besnike çelshin gropa antikarro, llagore, strehime. Mija trungje drujsh te prene nder pyje ishin shtri per te zane rruge dhe shtigje. Rreth uzinavet vebeshin pengesa me tela beku i. Keshtu edhe nder sheshe dhe rruget e parqeve te bukura.

— Xhaxhi, xhaxhi — thirrshin disa femij flokeverdhe, qe e percillshin Armaten e Kuqe ne terhjekje — Qe pjepna, dumate, dardha. Na, merrni!

Zavendes-shefi i Drejtoratit politik te frontit, Bogarev, ishte njikohesisht i knaqun dhe i mallngjyem thellesisht kur shifte se si e pershendetshin ata femij katundare Armaten e tyne ne terhjekje. Para luftes, Sergei Aleksandroviq Bogarev ishte profesor i marksizem-lenjinizmit ne nji shkolle syperjore te Moskes... Te kthyemen ne shtepi, nxirrte nga çanta e tij nji doreshkrim dhe e lexonte me vemendje te madhe. E shoqja e pyette ne se ia kishte pregadite gjellen simbas shijes se tij... Ai iu pergjegj se po lidhje, sepse s'e kishte mendjen aty. E shoqja idhnohej ase e qeshte. Ai i pergjigjej: „Shiqo, Liza, sot m'asht ba zemra mal tue e lexue nji leter te Marksit. Asht gjete tash vone nder arkiva te vjetra".

Bogarevi habitej per lehtesin me te cilen kishte muejte me u-shkepute mbrenda disa oreve, nga jeta e dikurshme. Ishte i knaqun qe e kishte rueite gjakftohtesin e vet nder situatat e veshtira, aftesin me veprue shpejte dhe me vendosmeni. Edhe ketu, ne lufte, ay kishte rueite vetinat e tija te mira: njerzit kishin besim ne te, e çmojshin dhe e ndijshin fuqin e tij morale. Por, prap, nuk knaqej me detyren qe ishte ngarkue. I dukej sikur ishte larg masës, larg ushtareve, dhe lakmonte me kalue nga Drejtoria politike ne vijen e zjarrit.

„Kurre, kurren e kurres — thoshte gjithnji Bogarevi — gjermanet nuk kane me e thye vendin t'one. Sa ma te perpikta jane llogarinat e tyne nder bollesinat ma te mira, sa ma fort qe levizjeke tyne t'u nenshtrohen ligjeve t'arithmetikes, sa ma te pazotet jane ata me kuptue ate qe ka randesin e dores se pare, aq ma e tmerrshme ka me qene katastrofa qe do t'u bjere mbi krye...".

Rinija e rrethit te Prizrenit dhe t'Istokut ne ndertimin e hekurudhes Kuçevo-Brodice

Nder akcjonet e shumta te rinis asht edhe hekurudha Kuçevo—Brodice, e cila ka randesi te madhe ekonomi he per Vendin t'one, mbassi atje gjinden pyje te mdhaja dhe mode te pasun ne minjere te ndryshme. Ne ndertimin e kesaj hekurudhe-me gjatesi prej 16 km.-marrin pjese te ri e te reja nga te gjitha anet e atdheut t'one. Nder keta jane te ri e te reja nga rrethi I Sharit dhe t'Istokut, te cilet formojne brigaden e perbashket prej 200 vetve, prej te cilve 70 jane shqiptare. Ne kete brigade pasqyrohet kjartazi vllazenimi e bashkimi i rinis s'one. Shqiptaret, serbet e malazezet, tue jetue se bashku, ndertojne hekurudhen e tyne. Keta vullnetare te ri, prej te cilve marrin pjese edhe 60 te reja, jetojne se bashku ne shoqni te ngushte vllaznore me njeni tjetrin.

Vullneti dhe deshira e madhe per ndertimin sa ma te shpejte t'atdheut t'one u-pa qe ne ditet e para. Se bashku kane vendose qe brigada e tyne te dale sulmuese dy here. Norma e punes plotesohej dhe tejkalohej 100%. Per nji te ri norma asht per te punue 1.5 meter kub toke, ndersa sejcili i ri po ploteson ma se pakti 3 meter kub. Nder'ta ka disa te ri qe punojne edhe 10 kubik toke, dhe si i tille, asht i rini Bali Fazlija nga rrethi i Istokut, i cili asht i pelodhshem dhe sulmues i brigades. Nji dite, tue punue, nga nxehtesija e diellit, u-turbullue dhe i ra te liket, e qendroi keshtu per 15 minuta rresht. Posa si erdhi ne vehte, komandanti i brigades e lejoi qe te pushonte gjate asaj dite, mirepo Balin nuk u-pajtue me mendimin e komandantit dhe i tha keshtu atij: „Shok komandant, mue me vjen keq qe e humba punen mbrenda ketyne 15 minutave, se lene ma qe te humbi diten e sotshme". Dhe me nji here Bali e vazhdoi punen me vrull te madh.

Nuk asht vetem Bali si sulmues, por ka edhe te tjere, si p.sh. Pjeter Gjeta, Vera Gongjiq, Brahmon Uka etj.

Veç punes fizike, te rijt t'one atje ngriben edhe kulturalisht. Per ta, hapi i pare per t'u ngrite ne sektorin kultural, asht paraqit nevoja e zhdukjes s'analfabetizmit. Prej 36 analfabetve, te gjithe kane premtue se kur te kthehen nder shtepijat e tyne kane me pa se te mesuem shkrimin e kendimin. Veç kesaj, ne brigade mbahen thema te ndryshme politike e shoqnore, jepen çfaqje theatrale dhe filmash te zgjedhun. Te rijte t'one po mesojne shum gjana te reja prej librave ma te dobishme ne grupet lexuese. Keshtu, tue ndertue hekurudhen, ata po ndertojne edhe vetvehten. Kur keta te ri do te kthehen prej punes, kane me qene t'afte me kontribue edhe ma shum n'organizaten e rinis, me i ndihmue shoket e katundeve e ate i mesme, dhe shpesh here edhe me i udhehjeqe per fitore e sukses ma te mdha ne çdo akcjon qe t'u paraqitet.

Mysherel Raifi

Me rastin e fillimit te punes ne prodhim te fabrikes se tullave ne Prishtine

Para pak ditesh, me inicjativen e drejtorit te tullave, shokut Ali Dauti dhe me deshiren e puntorve, u shtrue nji dreke, ku u ftuen udhehegsat e Keshillit dhe te Frontit popullor Krahinuer dhe pergjegjesa te disa sipermarrjeve te ndertimit etj. Puntoret ndijshin knaqsi qe tash ne Jugosllavin e re u jepet rasti jo vetem te bisedojne lirisht me udhehegsat, por edhe te hane bashke me ta ne nji tryeze.

N'emen te puntorve i pershendeti miqet per mireseardhje sekretari i deges sindikale t'atij sektori, shoku Mladen Nikoliq.

Drejtori i fabrikes i falenderoi miqet qe merrshin pjese per here te pare ne gezimin e puntorve te kesaj fabrike. Te gjithe bisedet e tij ia kushtoi kushteve te punes ne fabrike, permiresimit dhe shtimit ne kualitetet e kuantitetit te prodhimit te tullave etj.

„Shoke puntor — thot ai — ju e dini fort mire se ne çfare kushtesh kemi punue ne vjetin e kaluem, kemi pase krejt pak puntor te kualifikuem, ndersa sot ne mesin t'uej ka mjaft t'afte dhe te pavarun ne degen e punes s'one. Fabrika e jone, tash po pjeke per here te pare tulla, e sa shpejti, ka me pjeke edhe tjegulla — qe te gjitha jo vetem per nevojet e Prishtines, por edhe per ato te Krahines".

Ma ne fund ai keshtu e perfundoi biseden e tij: „ Sipermarrja dhe fabrika asht e jueja shoke — asht e popullit — dhe jo e ndonji kapitalisti te pangopun. Ju e shifni edhe vete se sa fort kujdeset pushteti dhe Fronti popullor per puntoret, e sidomos per shqiptaret, qe ne Jugosllavin e vjeter merreshin neper kambe.

Mbas ketij e muer fjalen shoku Gjoko Pajkoviq, sekretar i Frontit popullor Krahinuer dhe kryetar i Komisjonit te planit.

„Shoke puntor, se pari ju falenderojme per ftesen t'uej ne kete dreke modeste — thote shoku Pajkoviq. Na knaqemi qe se bashku po bisedojme dhe po i kalojme disa çaste gezimi, te cilat kurr nuk i kane kalue puntoret me drejtorin, nepunsat dhe pergjegjesat ne regjimin antipopullor te Jugosllavis se vjeter. Ju e shifni dhe vet, se sa ma shum fabrika shtohen ne Vendin t'one, aqe ma fort permirsohet jeta e puntorve dhe e katundarve. Tashma, fabrikat nuk jane ne duert e kapitalistave, por ne duert e jueja — ne duert e vet popullit. Pra asht detyre e jueja qe t'a mbroni ket pasuni si syt e ballit t'uej. Ju keni punue mire, por pritet qe te korrni sukses edhe ma te mira, pse vetem keshtu i bajme te pafuqishem armiqet e mbrendeshem e te jashtem, te cilet nuk ia duen te miren popujve t'one."

Shoku Gjoko Pajkoviq theksoi edhe nevojen e shtimit te prodhimit ma te madh dhe te zbritjes se çmimeve kobe mbas kobe, keshtu qe t'u jepet mundesija si puntorve ashtu edhe katundarve me ndertue banesa te pershtatshme per vehten e tyne".

„Qe popujt t'one i gezojne te drejtat e barabarta ne Jugosllavin e re, ashtu si e shifni edhe ju vete puntue shqiptar, qe ne shumice merrni pjese edhe ne kete fabrike — kjo i dedikohet Partis s'one te lavdishme Komuniste dhe udhehegsit e mesuesit t'one, shokut Tito - shtoi ai. „Sot per kete arsye puntoret e çdo sektori, tue e njofte Partin Komuniste si paraproje te vrten, jo vetem ne lufte por edhe ne paqe, po marrin detyrime te reja mbi vedi ne nder te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, prandaj edhe juve ju urojme sukses ma te mira ne punen t'uej — perfundoi shoku Pajkoviq.

Si punojne katundaret e Xerxes per shtepin e tyne kooperative

Katundaret t'one tue e kuptue randesin e madhe dhe rolin qe do te luej kooperativizmi nder katunde — permirsimin e jetes se tyne, ngritjen ne nji nivel ma te nalte kultural etj. — i jane pervesh edhe ma me hov punes — ne ndertimin e shtepijave kooperative. Keta po punojne me vetmohim te plote dersa e dijne fort mire qe djersa e tyne dhe mundi shkojne ne dobin direkte te tyne dhe te gjenaratave te reja, kah jeta ma e lumtun—socjalizmi.

Me kete hov punohet shtepija kooperative dhe ne katundin Xerxe. Vendasit tue pa se plank i saje asht me te vertete i ri dhe modern per katundin e tyne — me dyqane per shitje, per shkembime mallnash industrijale e prodhimesh bujqesore, me magazina, sille kinemaje dhe theatri e me dhoma leximit e konferencash, ata per çdo dite paraqiten ne pune simbas rradhes qe asht caktue n'organizimin e punes se gjithanshme. Te djelen, mbas nji konference qe mbajti Keshilli i Frontit Popullor ne Bellacerke, mbrrijten ne Xerxe te gjithe katundaret e reonit te ketij keshilli. Ma se 160 katundar punuen gjithe diten se bashku per kooperativen e Xerxes.

Asht mjaft karakteristik fakti qe ne kete akcjon muerren pjese edhe pionieret e shkolles se Xerxes, te cilet me duert e tyne te njoma ua afrojshin bashkekatundarve guret afer themeleve, largojshin dheun prej podrumeve dhe shkarkojshin zallin e guret prej qerreve.

H. Sopeca

Pasqyra e ndeshjeve

Te djelen, me 20 qershuer 1948 filloi ne Kosmet kampjonati per kupen e kualifikimit te Jugosllavis, Ne kuadrin e zones se peste Kosmet — Sanxhak u-zhvilluen keto ndeshje:

Ne Mitrovicë	Sh. F. Trepça—Sh. F. Polet (Prishtinë)	3:1
N'Istok	Sh. F. Radnik (Vuçiterne)—Sh. F. Istok	6:0
Ne Pejë	Sh. F. Buduçnost - Sh. F. „Vllaznija" Gjakovë	1:0
Ne Prishtinë	Sh. F. Bratstvo—Sh. F. Slloga (Liplan)	3:2
Ne Gillan	Sh. F. Metohija (Prizren)—Sh. F. Crvena Zvezda	4:2
Ne Ferizaj	Sh. F. Borac—Sh. F. Zheleznicar (Fushë Kosovë)	3:3
Ne Novi Pazar	Sh. F. Proleter (Prishtinë)—Sh. F. Sanxhak	2:0

Ne baze te rezultatere te siperme zbresin automatikisht nga kupa sh. f. Polet, sh. f. Istok, sh. f. Vllaznija, sh. f. Slloga, sh. f. Crvena Zvezda, sh. f. Zheleznicar e sh. f. Sanxhak.

Ndreqje gabimesh

Ne gazeten «Rilindja» Nr. 118, date 19 qershuer 1948, kane rreshqite keto gabime ne shtyp:

N'artikullin mbi huan popullore, i cili vazhdon ne faqen e dyte, ne shtyllen e katerte, ne rreshtat 4 e 5 ne vend te: nga 250 dinare e lthehet ne fund te vjetit 1952, duhet te jete: nga 250 dinare e kthehet deri ne fund te vjetit 1952-ne vjetin e pare 10%, ne vjetin e dyte 10 per qind, ne vjetin e trete 20 per qind e ne vjetin e fundit 60 per qind.

Ne faqen e trete, n'artikullin „ Rritja e krymbit te mendafshit ne Gjakove" ne kryerreshtin e katerte duhet te jete [illegible].

Njikohesisht na tregoi edhe nji katalog, ne te cilin na spjegoi fazen e tashme te bubave qe ajo po rrite.

Ne nenfleten, faqe tre, mbi titullin «Miljona vjete te burgyemi» ne vend t'emnit M. I. Kalinjin duhet me qene: J. Shur—nga libri „Nji minute".

Lajme nga bota e jashtme

Reforma e valutes ne Gjermanin prendimore — arme e ekspanzjonit Amerikan

Komandantat e zonave prendimore t'okupacjonit, gjeneralat Klei, Robertson e Kenig, n'emen te qeverinave te tyne, mueren vendimin mbi zbatimin e reformes separatiste te valutes ne Gjermani. Ata i refuzuen te gjitha propozimet e perparshme te perfaqsuesave sovjetik mbi zbatimin e reformes valutare te pergjithshme gjermane, e cila do t'ishte n'interes te popullit gjerman si dhe n'interes te zhvillimit te tregtis ndermjet zonave. Perfaqsuesat sovjetik ne Keshillin Kontrollues jane perpjeke me te gjitha forcat per reformen unike te parês, sepse ndertimi i unitetit ekonomik te Gjermanis asht ne konformitet te plote me vendimet e Potsdamit. Vetem politika ekonomike e pergjithshme gjermane asht n'interes te popullit gjerman. Perkundrazi, perfaqsuesat e fuqive prendimore t'okupacjonit e kane ba te pamundun realizimin e unitetit ekonomik te Gjermanis. Ata, tue zbatue vendimet e Konferences se „gjashte fuqive" ne Londer, kane ba edhe nji hap brutal kah perçamja e vertete e Gjermanis ne dy pjese dhe kah ringjallja e militarizmit gjerman.

Ne kundershtim me kontrollin e te katerve dhe me vendimet e Konferences se Jaltes e Potsdamit, zbatimi i te cilave do t'ishte garanci e krijimit dhe zhvillimit te Gjermanis paqedashese, Shtetet e Bashkueme t'Amerikes krijuen patronatin e tyne, ma perpikmisht—kolonin e tyne prendimore gjermane. Ekspansjonistat amerikan e suellen Gjermanin prendimore para pankorotimit finacjar. Ata e forcojne eksportimin e landeve te para, qymyrit, hekurit te vjeter e drunit, ndersa e pengojne prodhimin e industris paqesore. Deri tash zonat e prendimit u kane borxh Shteteve te Bashkueme t'Amerikes 1.8 miljard dollare. Ne vjetin 1948, tue marre parasysh kushtet e planit Marshall, ky borxh do te perfundohet me dificitin prej 1.2 miljard dollar. Keshtu borxhi i pergjithshem i Gjermanis perendimore qe duhet t'ua kthehej monopolistave amerikane, ne fund te ketij vjeti kapet ne 3 miljarda dollare. Barra e pagimit te kesaj huaje do te bije si peshe e rande ne kurrizin e popullsis puntore gjermane. Ky borxh ne realitet asht 6 here ma i gnadh se „ndihma" e Marshallit, e cila i asht dhane Gjermanis prendimore per kete vjet. Popullsija gjermane i asht ekspozue mjerimit gjithnji ma te madh per shkak te gjithfuqis dhe çfrytzimit te pashpirte te monopoleve amerikane ne Gjermani. Spekulantat, njerzit e tregut te zi dhe kriminelat nazista te luftes kane liri te plote te veprimit e pasunimi ne kurriz te klases puntore.

Reforma monetare ne zonat perendimore asht akti ma i ri i shkatrrimit te miljona njerezve gjermane. Reforma separatiste valutare e qet Gjermanin ne papunesi miljonash.

Reforma separatiste valutare ne zonat prendimore t'okupimit asht pjese perbase e planit Marshall te kolonizimit t'Europes prendimore. Ky hap ma i ri i ekspansjonistave amerikan, i drejtuem ne perçamjen definitive te Gjermanis, ka shkaktue pezmatim, nder masat e gjana popullore. Ne shum qyteete te Gjermanis prendimore shperthyen demonstrata masovike. Asht interesant me permend, gjithashtu, se zbatimi i politikes amerikane ne perçamjen e bashkimit ekonomik e politik te Gjermanis ka shkaktue diferencim si ne partin kristijan-demokrate ashtu edhe ne partin socjal-demokrate te Kurt Shumaherit.

Para tri javesh, 13 miljon gjerman u-shprehen kundra politikes robnuese amerikane. Ata u-shprehen per bashkimin ekonomik e politik te vendit te tyne, e prandaj edhe kundra reformes separatiste valutare, tue kerkue krijimin e Gjermanis demokratike. Ky asht fakt, te cilin duhet t'a marrin parasysh ekspansjonistat amerikan dhe vazalet e tyne anglo-franceze, sepse populli gjerman nuk dishron qe vendi i tij te kthehet ne prone kolonjale te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes.

Monarko-fashistat grek vazhdojne me provokime ne kufinin shqiptar

Agjensija telegrafike shqiptare lajmron:

Simbas komunikates se Drejtoris s'informatave, monarko-fashistat greke kane ba 12 provokime prej dates 10 deri me 20 qershuer. Me 18 qershuer ne mengjes nji patrulle greke hapi zjarrin nga mitrolozat ne patrullen shqiptare ne zonen e shtyllave kufitare Nr.12 dhe 13 ne sektorin e Bjovides (Leskovik). Po kete dite dy aeroplana grek fluturuen 500 metra thelle permbi teritorin shqiptar ne sektorin Bilisht, ndersa dy aeroplanat tjere po ne kete dite kane fluturue permbi teritorin shqiptar 1500 metra thelle. Me 19 qershuer dy aeroplana kane depertue 600 metra thelle permbi teritorin shqiptar dhe mandej jane larguе ne drejtim te katundit Biograde. Pak ma vone po ne kete sektor u duk nji aeroplan grek i cili hapi zjarr kundra rojes shqiptare te kufinit.

Me 20 qershuer ushtaret monarko-fashista dy here gjuejten me top nga katundi Kerasove ne sektorin e Koshovices. Ne nji here ushtaret greke nga katundi Kastanje gjuejten me dy predha mortaje ne drejtim te teritorit shqiptar. Veç ketyne, monarko fashistat greke kane krye ne ket kohe edhe nji seri provokimesh tjera kundra Shqipnis.

Operacjonet e sukseseshme t'Armates demokratike Greke

ATHINE:

Radjostacjoni i Greqis se lire transmeton komunikaten e Shtabit Madhnuer t'Armates Demokratike mbi operacjonet ne Maqedonin prendimore. Ne komunikate thuhet:

„Me 15 qershuer armiku, mbas perqendrimit te kryem te shum divizjoneve te kamsoris me ndihmen e madhe t'artileris dhe forcave ajrore, ndermuer sulme nder vargjet veriore te bjeshkve Pind. Lufta fitoi perpjestime te gjana sidomos ne sektorin e Kastonahorjes si dhe ne sektorin Koçice.

Me 21 qershuer u ndaluen tentativat e armikut ne territorin e Nestorjas. Ne keto lufta armiku la 231 te vdekun, 393 te plagosun dhe 20 ushtar u zuen robe, ndersa 10 u dorzuen vullnetarisht. U kapen dy mortaja te randa me sasina te mdhaja municjoni, 4 mitroloza „Vikers", 10 pushkomitroloza dhe sasina te mdhaja armesh, municjoni e materjali tjeter. Artilerija antiajrore rrezoi 5 aeroplana t'armikut. Armata demokratike la 15 te vdekun, 29 te plagosun dhe 5 te humbun.

Konferenca e ministrave te jashtem te shteteve demokratike ne Varshave

Korespondenti i Tanjugut lajmeron se ne Varshave ka mbrrijte delegacjoni i Qeveris se RFPJ me Ministrin e punve te jashtme Stanoje Simiq ne krye. Ne pritjen e delegacjonit ka marre pjese Ministri i punve te jashtme te Republikes Polonese Modzelevski dhe ambasadori i RFPJ ne Varshave Rade Pribiçeviq.

Gjate dites, gjithashtu kane mbrrijte ne Varshave Ministri i punve te jashtme te Republikes Ungareze Erik Molnar, Ministri i punve te jashtme te Republikes se Çekosllovakis Vlladimir Klementis, Ministri i punve te jashtme te R. P. te Bullgaris Vasil Kollarov, Ministri i punve te jashtme te R. P. te Rumanis Ana Pauker dhe Kryetari i Qeveris e Minister i punve te jashtme te R. P. te Shqipnis Enver Hoxha.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Popullor Pajtimet ne fle ture i Tiranes: Administrata dhe ekspedicioni.